

# **STATUT**

## **I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “MUHAMMED COMPANY 2022” SH.P.K.**

Mbështetur në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe në ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe në Akt - Themelimin e shoqërisë “MUHAMMED COMPANY 2022” sh.p.k. sot në datën 09 Maj 2023, unë ortaku themelues Aron Muço i datëlindjes 02.06.2002 me Kombësi dhe Shtetësi Shqiptare, banues në Pogradec, i identifikuar me nr. Personal K20602064W

### **VENDOSA:**

Me Akt - Themelimin e datës 09 Maj 2023, unë themeloj Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “MUHAMMED COMPANY 2022” sh.p.k.. dhe bazuar në përgjegjësitë e nënshkruara në atë Akt - Themelimi, hartoj dhe firmos këtë STATUT të kësaj Shoqërie Tregtare me këtë përmbajtje:

### **KRIJIMI**

#### **Neni 1**

Shoqëria “MUHAMMED COMPANY 2022” sh.p.k. është Person Juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë e quajtur Shoqëria).

### **SELIA DHE ADRESAT**

#### **Neni 2**

Selia e Shoqërisë “MUHAMMED COMPANY 2022” sh.p.k. është ne Pogradec në adresën:

Pasuria nr 14/449, Lagjja 4, Përroi i Çaprazit, Pogradec.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë adresa dytësore të tjera apo filiale, degë ose zyra përfaqësie. Shoqëria mund ta zhvillojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj, në përputhje me ligjet e vendeve përkatëse.

### **KOHËZGJATJA**

#### **Neni 3**

Kohëzgjatja e Shoqërisë “MUHAMMED COMPANY 2022” sh.p.k. është për një periudhë të pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo moment, sipas vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve.

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

#### **Neni 4**

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë Tregtare “MUHAMMED COMPANY 2022” sh.p.k. do të jetë:

Ndertime civile, industriale, ekonomike, turistike dhe bujqesore deri ne dy kate e mbi dy kate. Kompletimi dhe instalimi i veprave me karakter social kulturor dhe te kulteve te ndryshme fetare si dhe restaurime dhe rikonstrukcion godinash civile e ekonomike dhe veshje fasadash. Ndertim rruges te kategorise se pare deri ne te peste ndertim dhe asfaltim rruges dhe autostrada, punime te sinjalistikes rrugore, vijeze rruges, objekte te ndryshme, vepra arti, mure prites e mbajtes etj. Ndertim utesjellesa, kanale vaditese dhe kanalizime, mirembajtje dhe zhvillim i dekorit ne mjediset urbane. Kryerje punimesh te inxhinjerise civile te te gjitha llojeve e te veprave te artit, riparime e mirembajtje te veprave ekzistuese, izolime mbi dhe nentoke nga ujrart siperfaqesore. Punime hidraulike, druri, elektrike, melamine dhe konstrukte metalike, hidroizolimi dhe ngrohje. Punime ne fushen e sherbimeve civile, pastrim mbetjesh urbane, pastrim e gjelberim, mbjellje bari dhe krijimi masiveve pyjore.

Tregtim materiale elektronike, elektrike, higjeno sanitare. Tregtim dhe montim sisteme ngrohje dhe soba e kaldaja ngrohje. Montimi i materialeve duralumini, duroplast dhe mobilje.

Shërbime mbikqyrje, administrimi, ndihmëse në fushën e parkimit me pagesë të mjeteve motorrike të të gjitha llojeve ose mjeteve të tjera jo motorrike.

Dhënie dhe marrje me qera të ambienteve të ndryshme, dhënie me nënqera.

Restorant, bar-bufe, lavazho, gomisteri, shërbim taksi, makina me qera dhe shitblerje makinash.

Tregëtim mallrash, materialeve të ndryshme, tregti me shumicë dhe pakicë, artikuj të ndryshëm industrialë, ushqimorë, hidrosanitarë, elektrikë, etj.

Transport Mallrash për vete dhe për të tretë, brenda dhe jashte vendit, Import, Eksport. Si dhe çdo gjë që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të aktivitetit të shoqërisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar.

## **KAPITALI**

### **Neni 5**

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100.000 (Nëqind mijë) lekë i ndarë në 1 (një) kuotë. Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga Ortaku i Shoqërisë z. Aron Muço, i cili zotëron 100% të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, në shërbime nëpërmjet emërimit të një Eksperti Kontabël të Autorizuar ose Kontabilisti të Miratuar, për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së Administratorit.

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të zvogëlohet me Vendim të Asamblesë së Ortakëve në të njëjtat kushte që kërkohet për ndryshimin e Statutit.

Vendimi për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga Administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

## **TRANSFERIMI I KAPITALIT**

### **Neni 6**

Ortaku që mund të kërkojë të shesë apo transferojë kuotat e tij, tërësisht apo pjesërisht, më parë duhet të njoftojë ortakët e tjerë të Shoqërisë. Ortakët kanë të drejtën e parablerjes.

Në rastin e mos ushtrimit të të drejtës së blerjes së parë, ortaku që do shesë kuotat duhet të njoftojë emrin e blerësit jashtë Shoqërisë, dhe kushtet të cilat nuk duhet të jenë më të favorshme sesa ato të orfuara ortakëve të Shoqërisë.

## **ORGANET VENDIM MARRËSE DHE DREJTUESE**

### **Neni 7**

Asambleja e Ortakëve është organi vendimmarrës i Shoqërisë dhe miraton çdo ndryshim të Statutit sipas modaliteteve të përcaktuara me ligj. Çdo ndryshim Statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

### **Asambleja e Ortakëve ka këto të drejta kryesore:**

- të administrojë aktivitetin e Shoqërisë në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit.

- të marrë pjesë në fitimet e aktivitetit të Shoqërisë të parashikuara nga Statuti dhe Akt-Themelimi.
- të marrë në çdo moment dokumenta si raporti i administrimit, inventarë dhe llogari vjetore për tre vitet e fundit financiar.

### **Asambleja e Ortakëve ka këto detyrime kryesore:**

- të depozitohet kuotën fillestare të nevojshme si dhe ato suplementare, në përputhje me Statutin dhe Aktin të Themelimit.
- të marrë pjesë në administrimin e Shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga ajo vetë.
- të përmbushë të gjitha detyrat për realizimin e objektivave dhe funksioneve të Shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve, vendos për çështje të tilla si:

- a) Përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë.
- b) Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, (ose Kontabilistëve të Miratuar).
- c) Përcaktimin e shpërblimeve.
- d) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare, duke përfshirë përgatitjen e Pasqyrave Financiare Vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- e) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve.
- f) Çdo çështje tjetër brenda kompetencave të saj sipas Ligjit.

## **ADMINISTRIMI**

### **Neni 8**

Administratori i Shoqërisë Tregtare "MUHAMMED COMPANY 2022" sh.p.k. do të jetë z. Aron Muço, detyrat dhe kompetencat e së cilit përcaktohen në Statut.

Administratori i Shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## **KOMPETENCAT**

### **Neni 9**

Administratori ka të drejta dhe detyrohet të:

- a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga Asambleja e Ortakëve.
- b) Përfaqëson Shoqërinë tregtare, kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të Shoqërisë.
- c) Përgatit dhe nënshkruan Bilancin Vjetor dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumenta përpara Asamblesë së Ortakëve për miratim.
- d) Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë.
- e) Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- f) Raporton përpara Asamblesë së Ortakëve, në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe në realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë tregtare
- g) Kryen detyra të tjera të përcaktuara sipas Ligjit dhe sipas këtij Statuti.

## **VITI FINANCIAR**

### **Neni 10**

Çdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Miratimi i Bilancit Vjetor bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

## **EKSPERTËT**

### **Neni 11**

Në rast se Asambleja e Ortakëve e gjykon të arsyeshme ose nëse kërkohet në mënyrë të shprehur në ligj, kontrolli i llogarive të Shoqërisë kryhet nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar. Shkarkimi i Ekspertit Kontabël të Autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si dhe emërimi.

## **FONDET E SHOQËRISË**

### **Neni 12**

Shoqëria kryen veprimtarinë e saj me mjetet e investuara në fondet e saj dhe me mjete të tjera. Ajo është e detyruar që vëllimin e punës së saj ta ushtrojë në varësi me shumën e mjeteve të investuara në fondin themeltar të Shoqërisë dhe nga shuma e mjeteve të rezervës.

Shoqëria përcakton fondet e mëposhtme:

1-Fondi Themeltar.

2-Fondi Rezervë.

Për ushtrimin e veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të përcaktojë edhe fonde të tjera.

## **FONDI THEMELTAR**

### **Neni 13**

Fondi themeltar formohet nga mjetet e investuara nga Ortakët dhe nga mjetet e tjera në para ose në formë tjetër të investuar.

Shoqëria shfrytëzon fondin themeltar për ushtrimin e veprimtarisë së saj për investime në fondet e personave të tjerë juridikë dhe fizikë si dhe për të përballuar rreziqet pas shfrytëzimit të mjeteve të rezervës.

Gjithashtu, mund ti shfrytëzojë edhe për destinime të tjera sipas interesit të Shoqërisë.

## **FONDI REZERVË**

### **Neni 14**

Fondi rezervë i Shoqërisë formohet nga një pjesë e fitimit që Shoqëria realizon gjatë veprimtarisë së saj. Ai përcaktohet me vendim të veçantë të Asamblesë së Ortakëve. Fondi rezervë mund të përdoret edhe për destinacione të tjera që janë në përputhje me interesat e Shoqërisë.

## **DIVIDENTËT**

### **Neni 15**

Pas miratimit të Pasqyrave Financiare dhe llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asambleja e Ortakëve përcakton pjesën që i takon Ortakëve në formën e dividendëve. Fitimi neto që do shpërndahet, përbëhet nga fitimi i Vitit financiar, të cilit i është zbritur shuma e lënë mënjanë për fondin rezervë të domosdoshëm (5% e fitimit të çdo viti) si dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose shtuar respektivisht humbjet ose fitimet e mbartura nga vitet e mëparshëm financiarë sipas ligjit.

## **PRISHJA E SHOQËRISË**

### **Neni 16**

Shoqëria priset në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Statut ose me Vendimin Asamblesë së Ortakëve. Shkaqet e prishjes së Shoqërisë:

- Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj.
- Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- Me hapjen e procedurave të Falimentimit.
- Me vendim të Gjykatës.

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likujdimit të Shoqërisë, duke caktuar një ose disa likujditorë, dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në Likujdim e sipër". Prishja e Shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likujdimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

## **LIKUJDIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 17**

Shoqëria hyn në procesin e Likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Asambleja e Ortakëve emëron një ose disa likujdues të cilëti paraqesin raportin mbi gjendjen e Aktivitetit dhe të Pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e domosdoshëm të përfundimit të tyre.

## **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E LIKUJDUESIT TË SHOQËRISË**

### **Neni 18**

Detyra e Likujduesit/Likujduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të Shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të Shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar rradhën e referimit sipas nenit 605 të Kodit Civil. Likujduesi/Likujduesit mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

Nëse në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, Likujduesi/Likujduesit vërejnë se pasuria e Shoqërisë nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, atëherë Likujduesi /Likujduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e Likujdimit dhe ti kërkojnë Gjykatës nisjen e Procedurave të Falimentimit.

Likujduesi/Likujduesit përgatit një Bilanc të gjendjes së Shoqërisë në çastin e hapjes së likujdimit dhe një Bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave.

## **PËRFUNDIMI I LIKUJDIMIT TË SHOQËRISË**

### **Neni 19**

Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të Kapitalit themeltar tek kontribuesit, Likujduesi/Likujduesit i ndan kapitalet e mbetura Ortakëve dhe njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likujdimit dhe kërkon çregjistrimin e Shoqërisë.

## **SHNDËRRIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 20**

Shoqëria mund të ndryshojë formën e vet ligjore nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionere. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat dhe detyrimet që Shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

## **INTERPRETIMET STATUTORE**

### **Neni 21**

Pavlefshmëria e dispozitave të veçanta të kësaj marrveshje nuk e prek tërësinë e saj vepruese. Në vend të dispozitave të pavlefshme ose për mbushjen e hapësirave statutore, Ortakët bien dakort për një rregullim të përshtatshëm, në përputhje me qëllimin e hartimit të këtij Statuti duke ruajtur interesat e Shoqërisë.

Për gjithçka jo të parashikuar në këtë Statut, do të respektohen normat ligjore të Legjislacionit shqiptar në fuqi.

Për mosmarrveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, si dhe për çdo mosmarrveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

## **DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 22**

Për të gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Për efekt të interpretimit të këtij Statuti me ligj tregtar nënkuptohet ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Pavlefshmëritë eventuale të dispozitave të veçanta të këtij Statuti, nuk mund të çënojnë vlefshmërinë në tërësi të tij.

Ky Statut hartohet në 4 (katër) ekzemplarë originalë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

## **ORTAKU**

Aron Maço  
